REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERZIAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr."Dëshmorët e Kombit" p.n.

# *Raport i ecurisë së konsultimit publik me qytetarët për: Projekt- Rregulloren për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me taksi*

**Korrik 2025**

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr."Dëshmorët e Kombit" p.n.

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur.

Publikimet:

Në uebfaqe:

https://ferizaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Njoftim-shqip.pdf

Në platformë:

https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42845

Me 10.07.2025, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e lajmi për mbajtjen e konsultimit:

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr."Dëshmorët e Kombit" p.n.

Projekt-Rregullorja për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me taksi, iu është dorëzuar fizikisht, pjesëmarrësit të cilët ishin në konsultim publik, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

Me 14.07.2025, është publikuar procesverbali për mbajtjen e konsultimit publik, procesverbali është i publikuar në këtë vegëz:

Dokumenti ka qenë në konsultim publik në uebfaqen zyrtare të komunës dhe platformën e konsultime publike, nga data 26.06.2025 deri me 27.07.2025, ndërsa komentet janë pranuar deri me datë 27.07.2025.

Përmes formës elektronike në e-mailat e zyrtarëve përgjegjës për pranimin e komenteve, nuk është pranuar asnjë koment nga ana e qytetarëve,

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr."Dëshmorët e Kombit" p.n.

komente nuk ka pasur as në formën elektronike. Gjithashtu nuk ka pasur komente as në mbajtjen e konsultimit publik.

Takimi i fundit i grupit punues është mbajtur me 28.07.2025, dhe është diskutuar për pranimin e komenteve si në formë elektronike, gjatë konsultimit apo edhe në formë fizike, anëtarët e komisionit prezent në takim kanë thënë se kanë pranuar vetëm një koment në emalin zyrtare.

**Tabelori me të dhëna të shkurtra:**

| **Metodat e konsultimit** | **Data / Kohëzgjatja** | **Numri i pjesëmarrësve** | **Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime** | **Numri i kërkesave të pranuara** |
|---|---|---|---|---|
| 1-Takim i drejtpërdrejtë me qytetarë pwr ***: Projekt-Rregulloren për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të*** | 20.01.2025 | F M T<br>1 26 27 | 0 | 0 |

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr."Dëshmorët e Kombit" p.n.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ***udhëtarëve me taksi*** | | | | |
| Është mbajtur 1 konsultim publik | **30 minuta ka zgjatur konsultimi** | **Totali i pjesëmarrëseve:**<br>**F M T**<br>2 11 13 | **Totali i qytetarëve që kanë dhënë komente, kërkesa/sugjerime:** | **Totali i kërkesave: 1** |

Shtojca-Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuara dhe të refuzuara.

| Nr | Kërkesat /Sugjerimet / Komentet | Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për : Projekt-Rregulloren për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me taksi | Statusi i kërkesës /sugjerimi i pranuar , pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar | Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm) |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr."Dëshmorët e Kombit" p.n.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **1.** | Kërkoi sqarim lidhur me nenin 3 dhe 6 të projekt-rregullores, konkretisht për mënyrën se si është përcaktuar numri i licencave dhe mbi çfarë baze është marrë një vendim i tillë. | **Shefki Berisha – Avonet** | Është sqaruar neni 6 i Rregullores. | Numri i licensave/lejeve është bazuar në numrin e veturave taksi ekzistues, numrin e veturave taksi për kokë banori si dhe është marr parasysh edhe insfratstuktura rrugore, praktikisht numri i vend-parkingjet për këtë kategori dhe mundësia e mbulimit të operimit nëpër rrugët urbane. |
| **2.** | Shprehu shqetësimin për dhënien e licencave të reja, duke theksuar se aktualisht ekzistojnë gjashtë kompani që tashmë kanë mungesë të shoferëve dhe mund të mbulojnë nevojat ekzistuese pa shtim të operatorëve të rinj. | **Rexhep Demolli – Golden Taksi** | Nuk është pranuar sugjerimi. | Komuna e Ferizajt nuk ka ndonjë dokument zyrtar apo standart me të cilën ka të rregulluar numrin dhe llojin e bisneseve që mund të operojn brenda territorit të Komunës, mirëpo duke pasur parasysh numrin aktual të lejeve taksi, numrin e banorëve, kushtet në infrastukturën rrugore, zgjerimin e qytetit dhe kushtet tjera, grupi i ekspertëve që e kanë hartuar rregulloren kanë dhënë mendimin e tyre për numrin e lejeve për operatorë taksi dhe taksi individual. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **3.** | Koment për nenin 6 të Draft rregullores:<br><br>1. Komuna e Ferizajt gjatë 5 viteve të fundit nuk është përballur me fluks të kërkesave për licencë për ushtrimin e veprimtarisë së udhëtareve me taksi, andaj kërkojmë që të mos penalizohemi dhe në këtë rregullore kërkojmë të jetë e hapur konkurrenca e drejtë dhe e mirëfilltë.<br><br>Mos hyrja në treg e operatorëve të rinjë shkakton çmime më të lartë, cilësi më të dobët, mungesë zgjedhjeje, ulje e inovacionit, efikasitet i dobet.<br><br>Mbajtja e tregjeve të hapura, rritja e pjesëmarrjes të sipërmarrjeve të reja dhe kontrolli i praktikave anti-konkurruese janë çelësi për zhvillim ekonomik, inovacion dhe prosperitet për të gjithë.Po ashtu një treg i hapur, Lehtëson investimet e huaja dhe zhvillimin e sipërmarrjes: Të huajt mund të hyjnë lehtësisht në tregje të hapura, duke sjellë teknologji dhe punësim të ri | **Hilmi Canolli – Teslla**: | Pjesërisht është pranuar sugjerimi. | Bazuar në nenin 6 paragrafi 1 të Ligjit për Transport Rrugor Nr. 04/L-179, Komuna e Ferizajt përcakton politikat e zhvillimit të shërbimeve të transportit rrugor të sigurta, efikase dhe ekonomike brenda kufijve administrativë të Komunës, praktikisht sipas nenit 15 paragrafi 2, Komuna është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit taksi të udhëtarëve brenda territorit te saj, ku bazuar në këto parime ka hartuar edhe Rregulloren për Organizimin e Transportit Rrugor Taksi, duke mos përjashtuar edhe mundësin e dhënjeve të lejeve të reja. |

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET
Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr."Dëshmorët e Kombit" p.n.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | .Tregjet konkurruese i inkurajojnë bizneset të inovojnë dhe të përmirësojnë produktet dhe shërbimet e tyre për të tërhequr klientët. Mbyllja e tregjeve mund të zvogëlojë konkurrencën, duke çuar në stanjacion dhe mungesë inovacioni. Konkurrenca e drejtë dhe hapja e tregut janë dy dimensione që bashkë mbështesin një ekonomi vitale, inovative dhe transparente.<br><br>Po ashtu nëse tregjet janë të mbyllura për periudha të gjata, kjo mund të ndikojë negativisht në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik, duke çuar në humbje vendesh pune dhe ulje të rritjes ekonomike.<br><br>Një mjedis konkurrues siguron, që të ketë hyrës potencial në garë për të ofruar një produkt të ri apo për të ofruar një shërbim më të mirë. Si pasojë, konkurrenca e fuqishme përbën nxitësin kryesorë të rritjes së produktivitetit dhe siguron që tregu do të jetë konkurrues. Një mjedis konkurrues i mirëfilltë, jep mundësi të zgjedhjes, | | | |

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET
Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr."Dëshmorët e Kombit" p.n.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | shërbime më të mira, cilësi, çmime konkurruese dhe produkte të reja (inovacione).<br><br>2. Të shqyrtohet kërkesa jonë për licencimin e kompanisë sonë në Komunën e Ferizajt.<br><br>Ju shkruajmë me përgjegjësi të plotë që plotësojmë të gjitha kushtet e paraqitura në draft rregulloren e taksive, dhe kërkojmë licensimin e kompanisë sonë me 5 deri në 15 vetura në komunën e Ferizajt. | | | |
| **4.** | Propozoi që të mundësohet shtimi i numrit të veturave në kuadër të kompanive ekzistuese deri në 30, pa e rritur numrin e operatorëve të rinj në treg. | **Korab Demolli – Golden Taksi**: | Pjesërisht është pranuar sugjerimi. | Meqenëse nga thuajse të gjithë operatorët taksi është kërkuar që të rritet numri i veturave taksi, grupi i ekspertëve propozoi që numri maksimum që ka qenë 15 vetura të rritet edhe për 5 vetura, praktikisht neni 8 pika 1.4. ndryshohet "*Të ketë flotën prej minimum 5 (pesë) automjete dhe jo më shumë se 20 automjete*". |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **5.** | Parashtrroi nevojën që të arrihet një marrëveshje për çmimet e shërbimit të taksive, në mënyrë që të sigurohet stabilitet ekonomik për operatorët dhe cilësi për qytetarët. | **Skënder Ismajli – Autotaksi**: | **Nuk është pranuar sugjerimi.** | Komuna e Ferizajt nuk ka të drejtë të përcaktojë çmime fikse për kryerjen e këtyre shërbimeve. |
| **6.** | Kërkoi që të vendosen shenja të posaçme për automjetet autotaksi në qytet, duke theksuar vështirësitë aktuale në mungesë të këtyre sinjalizimeve. | **Avdullah Sejdiu – Autotaksi**: | **Është prnuar sugjerimi.** | Komuna e Ferizajt – Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë për çdo vit mirëmban rrugët me shenja vertikale dhe horizontale të trafikut. |

**Shkurtesat:**

F-Femra

M-Meshkuj

T-Totali

Raporti është përgatitur nga:

Shyhrete Topalli-Rexhepi

Udhëheqëse e Zyrës për Informim dhe Komunikim me Publikun